



Republika e Kosovës / Br. 14-98/2018
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 399/2018
Datë: 7 shtator 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 11 të Rregullores Nr.02/2015 për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 7 shtator 2018 – KPK/Nr. 369/2018, shpall:

KONKURS PUBLIK

(RISHPALLJE)

Për pozitën e Anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile

- I. Kandidatët e nominuar për pozitën e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 1. Të jenë shtetas dhe banor të Republikës së Kosovës;
 2. Të kenë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
 3. Të kenë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
 4. Të kenë përvojë pune në çështjet ligjore prej pesë (5) vjetësh;
 5. Të jenë të paanshëm politikisht për të paktën tre (3) vjetët e fundit;
 6. Të kenë përkrahjen e së paku pesë (5) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
 7. Të mos jenë të dënuar për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes, siç përkufizohet me ligj;
- II. Shoqëria civile duhet t'ia bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati plotëson kushtet e paraqitura me këtë shpallje publike.
- III. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon shoqërinë civile që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të Këshillit, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranura të barazisë gjinore.
- IV. Konkursi do të jetë i hapur nga data 17.09.2018 deri më 01.10.2018.
- V. Propozimet dhe dokumentet shtesë duhet të dërgohen të mbyllura në zarf në katin e pestë (5) të ndërtesës së Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj", Prishtinë, zyra numër 504.